

KËRKESË
Nr. 1835/7, datë 5.6.2013

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By pass Perëndimor Shkodër”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, do të likuidohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 216 807 913 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi